



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 nëntor 2013  
Nr. ref.:RK494/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastet nr.**  
**KI 73/13,**  
**KI102/13,**  
**KI105/13,**  
**KI106/13,**  
**KI113/13,**  
**KI117/13**  
**KI130/13**

Parashtrues

**Hamdi Ademi dhe 6 të tjerë**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit ASC-11-0069 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 22 prillit 2013, dhe të Aktgjykimit SCEL-09-0001 të Trupit gjykses të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 10 qershorit 2011**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

## **Parashtruesit e kërkesave**

1. Kërkesat janë dorëzuar nga Hamdi Ademi nga fshati Gllamnik i komunës së Podujevës; Fejzullah Humolli nga fshati Lupç i Poshtëm i komunës së Podujevës; Rifat Agushi; Selman Tahiri; Ismail Maksuti; Ukë Rrustemi nga Podujeva dhe Ferat Haliti nga Obiliqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit).

## **Vendimet e kontestuara**

2. Parashtruesit e kontestojnë Vendimin ASC-11-0069 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), të 22 prillit 2013, dhe Aktgjykimin SCEL-09-0001 të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, të 10 qershorit 2011. Data e dorëzimit të vendimeve të parashtruesit e kërkesave është e panjohur.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar lidhur me të drejtën e pretenduar të parashtruesve në një pjesë të të ardhurave të fituara nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”).

## **Baza juridike**

4. Kërkesat bazohen në nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Parashtruesit i kanë dorëzuar kërkesat e tyre duke filluar nga 16 maji 2013 deri më 21 gusht 2013.
6. Më 10 qershor dhe 29 gusht 2013, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesave. Në datat e njëjta, Gjykata ua komunikoi kërkesat Dhomës së Posaçme dhe Agjencisë së Privatizimit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: AKP).
7. Më 10 shtator 2013, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesave KI102/13, KI105/13, KI106/13, KI113/13, KI117/13 dhe KI130/13 me kërkesën KI73/13.
8. Më 10 shtator 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 16 shtator 2013, Gjykata, në pajtim me rregullin 37 të Rregullores së punës, i njoftoi parashtruesit në lidhje me bashkimin e kërkesave.

10. Më 17 tetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

#### **Përmbledhja e fakteve përkitazi me kërkesat**

**KI102/13 (Fejzullah Humolli),  
KI105/13 (Rifat Agushi), dhe  
KI106/13 (Selman Tahiri)**

11. Në një periudhë të caktuar kohore, parashtruesit ishin të punësuar si punëtorë të NSH-së "Ramiz Sadiku."
12. Më 27 qershor 2006, u privatizua NSH "Ramiz Sadiku".
13. Në mars 2009, parashtruesit kërkuan nga Dhoma e Posaçme që të përfshihen në listën e punëtorëve me të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku."
14. Më 10 qershor 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi SCEL-09-0001) i refuzoi kërkesat e parashtruesve, duke konstatuar se parashtruesit nuk i kishin plotësuar kushtet nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime, pasi që ata kishin arritur moshën e pensionimit para privatizimit të NSH "Ramiz Sadiku".
15. Në korrik 2011, parashtruesit u ankuan në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme kundër Aktgjykimit të Trupit gjykues.
16. Më 22 prill 2013, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi ASC-11-0069) i refuzoi ankesat e parashtruesve dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Trupit gjykues.

#### **Përmbledhja e fakteve përkitazi me kërkesat**

**KI73/13 (Hamdi Ademi),  
KI113/13 (Ferat Haliti),  
KI117/13 (Ismail Maksuti), dhe  
KI130/13 (Ukë Rrustemi)**

17. Në mars 2009, parashtruesit kërkuan nga Dhoma e Posaçme që të përfshihen në listën e punëtorëve me të drejtë në pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku".
18. Më 10 qershor 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi SCEL-09-0001) i refuzoi kërkesat e parashtruesve, duke konstatuar se parashtruesit nuk i kishin plotësuar kushtet nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime, pasi që ata kishin arritur moshën e pensionimit para privatizimit të NSH "Ramiz Sadiku".
19. Parashtruesit ushtruan ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykues, "*për shkak të: fakteve të gabuara, shkeljes të së drejtës materiale dhe shkeljes të së drejtës procedurale.*"

20. Më 18 nëntor 2011, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme i urdhëroi (ASC-11-0069-A0076) parashtruesit që brenda katërbëdhjetë (14) ditëve nga dita e pranimit të urdhrat të lartcekur: i) (...); ii) t'i tregojnë datat kur i kishin pranuar aktgjykimet e ankimuar; dhe iii) nëse parashtruesit nuk arrijnë të dorëzojnë ankesat e plotësuara ose të përmirësuara, të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 28.2 (f) të UA të UNMIK-ut 2008/6 (në lidhje me nenin 58.2 leg cit) (...), Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme do t'i hedhë poshtë ankesat në bazë të papranueshmërisë.
21. Më 22 prill 2013, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi ASC-11-0069) i refuzoi ankesat e parashtruesve dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Trupit gjykues, SCEL-09-0001 në tërësi, në pjesën që ka të bëjë me ankesat e parashtruesve.

### **Ligji i aplikueshëm**

*“RREGULLORJA NR. 2003/13 MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE*

*Neni 10  
Të drejtat e të punësuarve*

*10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vjet. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.”*

### **Pretendimet e parashtruesve**

22. Parashtruesit pretendojnë “se ata kanë punuar në NSH “Ramiz Sadiku” në Prishtinë për shumë vite deri më 28 shkurt 1990, kur forcat serbe i larguan me dhunë nga puna dhe i diskriminuan ata”.
23. Parashtruesit pretendojnë se ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, në dëm të tyre, nga AKP-ja dhe DHPGJS-ja, sepse ata kishin kontribuar në NSH “Ramiz Sadiku” për shumë vite dhe prandaj pretendojnë se ata kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së së lartpërmendur. Parashtruesit nuk janë thirrur në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

### **Vlerësim i pranueshmërisë**

24. Gjykata Kushtetuese së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili parasheh:
1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*  
(...)
  7. *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
26. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:
- “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...).”*
27. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit ushtruan ankesë kundër Aktgjykimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme dhe se vendimi përfundimtar i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme është nxjerrë më 22 prill 2013. Parashtruesit i parashtruan kërkesat e tyre në Gjykatë në ditë të ndryshme të muajit maj, korrik dhe më 21 gusht 2013.
28. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit janë palë e autorizuar dhe i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm dhe se kërkesat janë dorëzuar brenda afatit katër mujor.
29. Sidoqoftë, Gjykata i referohet më tej nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*
30. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36(1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- (1) *Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
  - ...
  - c) *kërkesa është qartazi e bazuar.*
31. Parashtruesit në përgjithësi pretendojnë se “ata kanë kontribuar në NSH “Ramiz Sadiku” për shumë vite, prandaj ata pretendojnë se kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së së lartcekur”.
32. Siç u tha më lart, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi ASC-11-0069) e vërtetoi Aktgjykimin e Trupit gjykues, me të cilin konstatohet se parashtruesit nuk i kanë plotësuar kushtet nga neni 10.4 i Rregullores së

UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime, pasi që ata kishin arritur moshën e pensionimit para privatizimit të NSH “Ramiz Sadiku”.

33. Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme, duke iu përgjigjur pretendimeve të bëra nga parashtruesit, është i qartë dhe i arsyetuar mirë.
34. Gjykata konsideron se parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre për shkelje të dispozitave të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ata nuk tregojnë në asnjë mënyrë se Trupi gjykues dhe Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme ua kanë mohuar atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
35. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese e rithekson se roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28, shih edhe Rastin Nr. KI70/11, parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
36. Gjykata Kushtetuese gjithashtu thekson se vërtetimi i saktë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta; roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih rastin Akdivar kundër Turqisë, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, shih gjithashtu rastin KI86/11, parashtrues Milaim Berisha, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
37. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e gjykatave të rregullta t’i vlerësojnë provat që i kanë në dispozicion. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vlerësojë nëse procedurat e gjykatave të rregullta ishin të drejta në përgjithësi, duke përfshirë mënyrën se si janë marrë provat (Shih rastin, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, kërkesa e 10 korrikut 1991).
38. Gjykata vëren se parashtruesit as nuk kanë treguar se Dhoma e Posaçme ka vepruar në mënyrë arbitrare ose të padrejtë dhe as nuk kanë qartësuar saktësisht cilat të drejta dhe liri pretendojnë t’u jenë shkelur nga Dhoma e Posaçme. Në të vërtetë, parashtruesit as nuk e kanë ndërtuar rastin dhe as nuk kanë sjellë prova për atë se ata kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave, pavarësisht arritjes së moshës së pensionimit të tyre para privatizimit të NSH “Ramiz Sadiku”.
39. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk e kanë arsyetuar dhe as nuk kanë provuar pretendimin kryesor se e drejta për një pjesë të të ardhurave ekziston edhe pas arritjes së moshës së pensionimit para privatizimit. Prandaj, nuk është argumentuar asnjë pretendim për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore.

40. Për më tepër, pakënaqësia e parashtruesve me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentueshëm për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
41. Prandaj, kërkesat janë qartazi të pabazuara dhe, në pajtim me rregullin 36(1)(c) të Rregullores së punës, duhet të refuzohen si të papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113 (1) të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 17 tetor 2013, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani